



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 10, Datë 16.02.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR “RINOVIMIN E FASADËS,
NDËRTIMIN E SHITESËS FUNKSIONALE PËR MJEDIS HOTELERIE DHE SALLË
KONFERENCE”, NË STRUKTURËN HOTELIERE “ROGNER HOTEL TIRANA”,
ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN “DËSHMORËT E KOMBIT”, HOTEL
ROGNER, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për “Rinovimin e fasadës, ndërtimin e shtesës funksionale për mjedis hotelerie dhe Sallë Konference”, në strukturën hoteliere “Rogner Hotel Tirana”, me vendndodhje në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, Hotel Rogner, Bashkia Tiranë dhe subjekt kërkues “Golden Eagle” sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
 - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
 - b. Harta e Planvendosjes së Strukturave shtesë.
3. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



Z. ARBEN AHMETAJ

MINISTËR I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

Handwritten signature of Adelina Greca



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT